



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 702, datë 30.11.2023

PËR

SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE NR. 304 DATË 14.02.2013 DHE NR. 354 DATË 19.07.2013 TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË, PËR PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATIT {...} DHE VIJIMIN E SHQYRTIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 97 pika 3 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenet 66, 67, 68, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.
2. Vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR